

GJYKATA KOMUNALE E PEJES
Ceshtja nr 581/10
16 shtator 2010

NË EMËR TË POPULLIT

Kryetari I Trupit Gjykues Malcolm Simmons me procesmbajtese Robina Struthers në çështjen penale kundër (1) Bekim Lulit (ne tekstin ne vijim "i akuzuari i parë"), (2) Engjell Lulit (ne tekstin ne vijim "i padituri i dytë") dhe (3) Prenk Luli (ne tekstin ne vijim I pandehuri i tretë ") të gjithë te akuzuar në bazë të Aktakuzës Numer PP." 1644-1609 paraqitur nga Prokurori i Qarkut të Pejës, të datës 3 shtator 2009 dhe ndryshuar më 29 janar 2010 me veprën penale, Dhënia e Një Deklaratë të Rreme në bazë të nenit 307 (1) të Kodit Penal të Kosovës, pas mbajtjes se gjykimit kryesor në datat 14 korrik, 5 gusht, 14 shtator 2010 në te cilat znj Alenka Sagmeister-Ranzinger perfaqesonte Prokurorinë Komunale dhe të pandehurit, të cilët nuk ishin të përfaqësuar, më 16 shtator 2010 mori vendim dhe publikisht shpalli në vijim kete:

AKTGJYKIM

I akuzuari i parë Bekim Luli, emri I babait Nuhe Luli, nëna Jane, mbiemri I vajzerize Shkurreti, i lindur më 28 shkurt 1977 në fshatin Doblibare, Shqiptar i Kosovës, me numer identifikimi 1008864817, bujk, aktualisht me banim në fshatin Doblibare, i martuar, nuk ka fëmijë është

FAJTOR

që më 12 mars 2009, kur u paraqit si dëshmitar para Gjykatës së Qarkut të Pejës në rastin e Gjelosh Krasniqit, ai dha një deklaratë të rreme në të cilën deklaroi se më 24/03/1999 ai nuk e njihte Gjelosh Krasniqin, dhe se më 24 / 03/1999 Gjelosh Krasniqi me katër ushtarë të UÇK-së nuk kanë marrë pjesë në marrjen peng te Pashk Lulit, edhe pse ai e dinte se kjo nuk ishte e vërtetë.

Per kete arsye i akuzuari i parë ka kryer veprën penale Dhënia e një deklaratë të rreme në bazë të nenit 307 (1) te Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës dhe është

DENUAR

me burgim prej 5 muajsh, me kusht sipas nenit 43 të KPPK-se për një periudhë prej dy vjetësh nga data që Aktgjykimi merr formë të prerë.

Në përputhje me nenin 102 (1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës i akuzuari i parë do të paguajë shpenzimet e procedurës penale të cilat Gjykata i vlerëson në shumën e 50 (pesëdhjetë) Euro. I akuzuari i parë do të paguajë shumën 15 (pesëmbëdhjetë) euro në lidhje me Shumen e caktuar.

I pandehuri I dyte, Engjell Luli, emri I babait Nuhe Luli, emri I nënes Jane, mbiemri I vajzerise Shkurreti, i lindur më 11 tetor 1969 në fshatin Doblibare, Shqiptar i Kosovës, numri i identifikimit 1009362661, punonjës në industrinë e mermerit, aktualisht me banim në fshatin Doblibare, i martuar, baba i 4 fëmijëve është

FAKTOR

që më 17 mars 2009, kur u paraqit si dëshmitar para Gjykatës së Qarkut të Pejës në rastin e Gjelosh Krasniqit ai dha një deklaratë të rreme në atë kur deklaroi se më 24/03/1999 ai nuk e njihte Gjelosh Krasniqin, dhe se më 24 / 03/1999 Gjelosh Krasniqi me katër ushtarë të UÇK-së nuk kanë marrë pjesë në marrjen peng të Pashk Lulit, edhe pse ai e dinte që kjo nuk ishte e vërtetë.

Per kete arsye i akuzuari i dytë ka kryer veprën penale Dhënia e një deklaratë të rreme në bazë të nenit 307 (1) të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës dhe është

DENUAR

me burgim prej 5 muajsh, me kusht sipas nenit 43 të KPPK-se për një periudhë prej dy vjetësh nga data që Aktgjykimi merr formë të prerë.

Në përputhje me nenin 102 (1) të Kodit të Procedurës Penale

të Kosovës i akuzuari i parë do të paguajë shpenzimet e procedurës penale te cilat Gjykata i vlerëson në shumën 50(pesëdhjetë) Euro. I akuzuari i dytë do të paguajë shumën 15 (pesëmbëdhjetë) euro në lidhje me Shumen e caktuar.

I pandehuri i tretë Prenk Luli, emri I babait Mark Luli, emri I nenes Zyle, mbiemri I vajzerise Bardhi, i lindur më 22 gusht 1958 në fshatin Doblibare, shqiptar i Kosovës, me numer identifikimi 1003023512, punonjës në industrinë e mermerit, aktualisht me banim në fshatin Doblibare, i martuar, baba i 7 fëmijëve është

FAJTOR

që më 17 mars 2009, kur u paraqit si dëshmitar para Gjykatës së Qarkut të Pejës në rastin e Gjelosh Krasniqit ai dha një deklaratë të rreme në atë kur deklaroi se më 24/03/1999 ai nuk e njohte Gjelosh Krasniqin, dhe se më 24 / 03/1999 Gjelosh Krasniqi me katër ushtarë të UÇK-së nuk kishin ardhur në oborrin e shtëpisë së Nikollë Lulit dhe ti këne thene Pashk Lulit që të dalë dhe të shkojë me ta, edhe pse ai e dinte që kjo nuk ishte e vërtetë.

Per kete arsye i akuzuari i tretë ka kryer veprën penale Dhënia e një deklaratë të rreme në bazë të nenit 307 (1) te Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës dhe është

DENUAR

me burgim prej 5 muajsh, me kusht sipas nenit 43 të KPPK-se për një periudhë prej dy vjetësh nga data që Aktgjykimi merr formë të prerë.

Në përputhje me nenin 102 (1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës i akuzuari i tretë do të paguajë shpenzimet e procedurës penale te cilat Gjykata i vlerëson në shumën 50(pesëdhjetë) Euro. I akuzuari i tretë do të paguajë shumën 15 (pesëmbëdhjetë) euro në lidhje me Shumen e caktuar.

ARSYTIMI

Aktakuza e ngritur nga ana e Prokurorit Komunal Numër PP. 1644-1609 e datës 3 shtator 2009 dhe e ndryshuar më 29 janar 2010 akuzon nëntë të pandehur per dhënie te

deklarates se rreme në kundërshtim me nenin 307 Deklaratat (1) të Kodit Penal të Kosovës.

Më 21 korrik 2010 në bazë të nenit 34 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës kjo gjykate ka ndare ceshtjen e te pandehurit te parë, te dytë dhe të pandehurit te tretë nga të pandehurit e tjerë.

Sipas akuzes se Prokurorise I akuzuari I pare më 12 mars 2009, kur u paraqit si dëshmitar para Gjykatës së Qarkut të Pejës në rastin e Gjelosh Krasniqit, ai dha një deklaratë të rreme në të cilën deklaroi se më 24/03/1999 ai nuk e ka njohur Gjelosh Krasniqin, dhe se më 24 / 03/1999 Gjelosh Krasniqi me katër ushtarë të UÇK-së nuk kanë marrë pjesë në marrjen peng te Pashk Lulit, edhe pse ai e dinte se kjo nuk ishte e vërtetë.

Sipas akuzes se Prokurorise I akuzuari I dyte më 12 mars 2009, kur u paraqit si dëshmitar para Gjykatës së Qarkut të Pejës në rastin e Gjelosh Krasniqit, ai dha një deklaratë të rreme në të cilën deklaroi se më 24/03/1999 ai nuk e ka njohur Gjelosh Krasniqin, dhe se më 24 / 03/1999 Gjelosh Krasniqi me katër ushtarë të UÇK-së nuk kanë marrë pjesë në marrjen peng te Pashk Lulit, edhe pse ai e dinte se kjo nuk ishte e vërtetë.

Sipas akuzes se Prokurorise I akuzuari I trete më 17 mars 2009, kur u paraqit si dëshmitar para Gjykatës së Qarkut të Pejës në rastin e Gjelosh Krasniqit ai dha një deklaratë të rreme në atë kur deklaroi se më 24/03/1999 ai nuk e ka njohur Gjelosh Krasniqin, dhe se më 24 / 03/1999 Gjelosh Krasniqi me katër ushtarë të UÇK-së nuk kishin ardhur në oborrin e shtëpisë së Nikollë Lulit dhe ti kene thene Pashk Lulit qe të dalë dhe të shkojë me ta, edhe pse ai e dinte qe kjo nuk ishte e vërtetë.

Nuk ka kundërshtim qe ne 29 Prill 2009 ne ceshtjen me numer 67/09 Gjelosh Krasniqi eshte denuar nga kolegji I gjykates se Pejes per Krime te Luftes kunder popullsisive civile ne kundërshtim te nenit 142 te Kodit te RSFJ dhe nenit 3 dhe 147 te Konvente se Gjeneves, nenit 4 dhe II te Protokollit Shtese te Konventes se Gjeneves, kryer ne fshatin Doblbare, te Komunes se Gjakoves ne 24 Mars 1999.

Neni 307 (1) parashikon

Një dëshmitar, eksperti, përkthyesi i cili jep një deklaratë të rreme në procedurën gjyqësore, në procedurën për kundërvajtje, në procedurën administrative përpara një noteri publik, ose në procedurën disiplinore dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.

Gjykata konstaton se deklaratata duhet të lidhet me një fakt material dhe që dëshmitari e dinte që deklaratata ishte e rreme ose nuk kishte arsye për të besuar që deklaratata ishte e vërtetë.

1. I akuzuari i parë

I akuzuari i parë dëshmoi para Gjykatës së Qarkut të Pejës në rastin e Gjelosh Krasniqit më 12 mars 2009¹.

Perpara dëshmisë së tij në Gjykatë, më 16 mars të vitit 2008 i akuzuari i parë I dha një deklaratë policisë së UNMIK-ut në lidhje me faktet e kesaj çështjeje.

Aktakuza pretendonte se i pandehuri i parë dha një deklaratë të rreme, kur ai dëshmoi para gjykatës më 12 mars 2009, duke kryer një vepër penale sipas nenit 307 (1) të LPK-së.

Prokuroria paraqiti në kete rast se deklaratata e të akuzuarit e parë dhene para Gjykatës më 12 mars 2009 ishte, në disa aspekte materiale të rëndësishme, e rreme dhe e kundërshtonte deklaratën e tij të mëparshme.

1.1 Deklarata e dhënë për Policinë e UNMIK-ut më 16 mars 2008²

I akuzuari i parë deklaroi se më 24 mars 1999, në rreth 8 - 08:30 ai ishte në shtëpinë e xhaxhait të tij Nikoll Luli duke shikuar lajmet në TV.

Ai e përshkroi ardhjen e ushtarëve në shtëpi. Ai tha se një prej ushtarëve ishte Gjelosh Krasniqi nga fshati Nepole. Ai tha se nuk i njihte të tjerët. Ushtarët u larguan nga

¹ prova P1

² prova P2

shtëpia duke marrë me vete Pashk Lulin.

Ai deklaroi se Gjelosh Krasniqi I kërkoi Pashk Lulit armët e tij, një kallashnikov dhe një pistoletë.

Në deklaratën e tij ai iu referua një incidenti kur vëllai i tij Engjell Luli ishte duke punuar si roje sigurimi në një pompe të benzinës dhe ishte, siç pretendohet, kërcënuar nga Gjelosh Krasniqi.

Deklarata është shkruar në gjuhën shqipe dhe është e nënshkruar nga i akuzuari i parë.

1.2 Dëshmia para Gjykatës më 12 mars 2009³

I akuzuari i parë dëshmoi se në natën në fjalë ai ishte në shtëpinë e Kole Lulit në Doblibare kur pesë ushtarët hynë në oborrin e shtëpisë. Ushtarët ishin me uniforma me simbolin e UÇK-së. Ai dëshmoi se një nga ushtarët e prezantoi veten si Gjelosh Krasniqi. Ushtarët konfiskuan një armë me tytë të gjatë.

Ai tha se ai zbuloi në mëngjesin e ardhshëm që Pashk Lulin e kishin marrë. I akuzuari i parë e mohoi që ai e ka njohur Gjelosh Krasniqin. Ai tha se ushtari thjesht u prezantua si Gjelosh Krasniqi. Kjo kontradiktoi deklaratën e tij të parë.

I akuzuari i parë është marre në pyetje në lidhje me kontradiktat midis dëshmisë së tij para gjykatës dhe deklaratës se tij të 16 marsit 2008.

Prokurori Publik: *Unë jam duke iu referuar deklaratës tuaj të bëre në polici, nënparagrafi 21 faqe 110. A ju kujtohet që keni folur me hetuesit e UNMIK-ut?*

Bekim Luli: *kur kam dhene deklaratën?*

Prokurori Publik: *Po, paragrafi i parë, pothuajse në fund, duke filluar me "në oborr ...". A e thate këtë?*

Bekim Luli: *Kjo nuk është e vërtetë*

...

³ prova P1

Prokurori Publik: Sipas kësaj ju identifikuat Gjelosh Krasniqi si ai i cili kishte marrë rolin udhëheqës.

Bekim Luli: Kjo nuk është e vërtetë.

Prokurori Publik: Ju madje thoni se ai erdhi nga fshati Nepole i cili është vendi i lindjes dhe I banimit i Gjelosh Krasniqit, si është e mundur që nuk është e vërtetë, ju e keni nënshkruar atë?

Bekim Luli: Kjo nuk është e vërtetë

Prokurori Publik: Pra, si ke arritur të kjo; kur thoni se ai është nga Nepole?

Bekim Luli: kurrë nuk kam thënë se ai ishte nga fshati Nepole.

Prokurori Publik: Kjo është deklarata juaj e nënshkruar nga ju, ne te është e shkruar qartë Gjelosh Krasniqi Nepole Pejë dhe kete e keni nënshkruar.

Bekim Luli: Kjo nuk është e vërtetë.

Kryetari i Trupit Gjykes; Por ju e keni nënshkruar këtë, si mund të thoni se ju nuk e keni thënë këtë?

Bekim Luli: Unë jam i bindur se unë nuk e kam thënë, se, këto janë shtremberime që mund të kete bere gazetari.

Kryetari i Trupit Gjykes; Ne nuk jemi duke folur për gazetare, te kesh kujdes kur permend shtremberimet. Tani që Prokurori Publik ua rifreskoj kujtesën, cila është kujtesa juaj, kujtesa momentale?

Bekim Luli: Mbjaj mend që deklarata ime nuk ishte aq gjatë.

Kryetari i Trupit Gjykes; Kjo nuk është e vërtetë, sepse deklarata juaj filloj ne 14:13 dhe mbaroi ne 14:47.

Haxhi Millaku: Unë mendoj se ai është duke folur për vendin në fshat, ai është duke thënë gjëra të ndryshme, kjo është arsyeja pse ka konfuzion.

Kryetari i Trupit Gjykses; Për të eksploruar më tej, për sa kohë ishit në oborrin e xhaxhait tuaj?

Bekim Luli: Para se këta 5 njerëz të vinin, unë isha aty për rreth një orë, ata menjehere erdhën, moren xhaxhain tim, unë u nisa për në shtëpi, ishte mjaft shkurt.

Kryetari i Trupit Gjykses; Pra, pasi 5 personat erdhën, sa kohë pas kesaj u larguat?

Bekim Luli: Ata erdhën dhe na thane që do të marrim atë, nuk ishte gjatë, 15 minuta jo më gjatë.

Kryetari i Trupit Gjykses; atehere ju u larguat?

Bekim Luli: u largova nga shtëpia e xhaxhait tim.

Kryetari i Trupit Gjykses; Është e qartë tani, po ne lidhje me memorjen tuaj për ate që ndodhi, tani që Prokurori Publik ju konfrontoj dhe pasi unë po ju kujtoj që deklarata juaj nuk është marrë 5 vjet më parë, ajo është marrë në mars 2008.

Bekim Luli: Deklarata ...

Kryetari i Trupit Gjykses; Unë nuk dua të di më tepër në lidhje me deklaratën tuaj, unë dua të di për kujtesën tuaj të tanishme.

Bekim Luli: Kjo deklaratë ishte e shkurtër, unë nuk njoh asnjë nga 5 personat që kanë ardhur unë nuk mund të fajësoj ...

Kryetari i Trupit Gjykses; Përgjigja nuk është në përputhje me pyetjen time.? Cila është kujtesa tuaj tani pasi Prokurori Publik ju ka konfrontuar me deklaratën tuaj të mëparshme?

Bekim Luli: incidenti i...

Kryetari i Trupit Gjykses; Nuk ka fakte të veçanta.

Bekim Luli: Unë isha atje për shumë pak kohë, por unë i di fjalët që kam dhene gjate deklaratës, e cila është marrë në shtëpinë e xhaxhait tim Pashk Luli, kur

kam filluar këtë deklaratë ata kanë më bene pyetje të tilla si a e njeh GjeloSh Krasniqin.

Kryetari i Trupit Gjykoes; Me duhet t'ju ndaloj ketu; unë nuk jam i interesuar për këtë deklaratë, cila është kujtesa juaj tani? Ju thatë diçka, Prokurori Publik ju kujtoi diçka, dhe tani ju thoni gjëra të ndryshme.

Bekim Luli: Unë nuk e di si ta shpjegoj unë fola për incidentin.

Kryetari i Trupit Gjykoes; Po, por ka mospërputhje dhe ju jeni të obliguar për të dhënë sqarime, pra ju lutemi përgjigjuni. Flisni ju lutem. Ju nuk e thate në deklaratë, por këtu përpara panelit, ju thate se personi në mesin e 5 personave të tjerë që hynë në oborr u paraqit si GjeloShi; kjo është ajo që keni thënë këtu. Prokurori Publik kerkoi fjalën dhe tha se tani ka një ndryshim, sepse në deklaratën që ju dhate më 16 mars 2008 ju keni thënë diçka të ndryshme, ju thate se ka pasur 7 ushtarë të UÇK, në mesin e tyre ishte GjeloSh Krasniqi nga fshati Nepol dhe pastaj shtuat; që nuk i kam njohur ushtarët e tjerë; kuptimi i kësaj fjalie është që ju e keni njohur GjeloSh Krasniqin dhe që ju e njihnit atë pasi thate se ai ishte nga fshati Nepol. Në qoftë se unë nuk e njoh një person nuk mund të them se cili është fshati i tij, e kuptoni ndryshimin e 2 deklaratave?

Bekim Luli: Une kam dhene një deklaratë.

Kryetari i Trupit Gjykoes; Po, një këtu dhe një në polici, tani paneli do të dijë, pasi ka një ndryshim, cila është memorja juaj tani dhe ju jeni të detyruar të thoni të vërtetën.

Bekim Luli: Unë jam duke thënë të vërtetën, unë kurrë nuk kanë thënë se ai është GjeloSh Krasniqi.

Kryetari i Trupit Gjykoes; Cila është memorja juaj në keto momente, mos permendni deklaratën tuaj të mëparshme, ju lutemi përgjigjuni.

Bekim Luli: Unë isha atje për pak kohë dhe unë nuk mund të njihja ndonjë nga personat.

Kryetari i Trupit Gjykses; Pra, kjo është përgjigjja juaj.

Prokurori Publik: Ju tha kur u pyetet se sa ishin, ose çfarë armësh, ju thatë armë me tyta te gjata, por ju nuk mund ti shihnit ato.

Bekim Luli: Jo, sepse unë nuk isha atje.

Prokurori Publik: Së pari ju thate në polici, se Gjelosh Krasniqi mori këto dy armë dhe i tha Pashk Lulit hajde me ne, do të shkojnë në fshat dhe për të marrë me shume armë; si mundet qe një vit më parë ju mund të thoni se ato ishin një kallashnikov dhe një pistoletë?

Bekim Luli: Po unë kam qenë aty kur arma e gjatë është marrë, kur unë shkova te nesermen më thanë qe edhe pistoletën e tij e kishin marre.

Prokurori Publik: Nga kjo deklaratë duket se ju keni qenë aty kur janë marrë armet.

Bekim Luli: Nuk eshte e vertete, une e kam dhene deklaratën me vone.

Prokurori Publik: Pse e keni nënshkruar deklaratën atehere?

Bekim Luli: E kam nënshkruar këtë deklaratë pasi kushëriri im më tha se ata kishin marrë pistoletën.

Prokurori Publik: Perse e keni nënshkruar deklaratën?

Bekim Luli: Me thane per deklaratën nje dite me vone.

Prokurori Publik: Po, por nuk po I përgjigjeni pyetjeve te mia.

Bekim Luli: Po kjo eshte e shkruar në deklarate pasi më kishin thënë ishte marre nje pistoletë.

Kryetari i Trupit Gjykses; Vetëm për te qartësuar, pasi ju keni qenë në oborr, kur personat erdhën për të marrë Pashk Lulin, si mund të mos e kesh pare ate te dorezonte pushkën dhe pistoletën?

Bekim Luli: Kur personat kane ardhur unë nuk isha në oborr Isha duke pare TV, unë dola jashte dhe Prenku më tha qe kishin ardhur 5 ushtarë. I kam dëgjuar ata duke kërkuar armë.

Kryetari i Trupit Gjykses; Ke degjuat?

Bekim Luli: Njeri prej 5 personave u prezantua si Gjeloshi.

Kryetari i Trupit Gjykses; A e keni parë Pashk Lulin te dorëzonte armët?

Bekim Luli: Po armet.

Kryetari i Trupit Gjykses; A I pate te dyja armet apo vetem pushken?

Bekim Luli: Une isha brenda kushtu qe nuk mund te shihja.

Kryetari i Trupit Gjykses; Je thate qe pate viktimen duke dorezuar armet?

Bekim Luli: Armen.

Kryetari i Trupit Gjykses; Pistoleten apo pushken?

Bekim Luli: Pushken e gjate....⁴

...

Ferdinando Buatier: Në fillim, ju keni thënë që kini një lloj lidhje me Gjelosh Krasniqin. A është ashtu apo gaboj?

Bekim Luli: Gabim e keni.

Ferdinando Buatier: Në rregull. A mund të na thoni sa njerëz keni takuar atë natë?

Bekim Luli: Ishin 5 njerëz.

Ferdinando Buatier: Atë natë e keni parë për herë të

⁴ Pjese nga Procesverbali I 12.03.2009, faqet 14 – 17.

parë?

Bekim Luli: Nuk e njoha.

Ferdinando Buatier: Kur e keni parë për herë të parë?

Bekim Luli: Këtu në gjykatë.

Ferdinando Buatier: Kthehemi te personi që e quajti veten Gjelosh më 24 mars 1999. A e takuat pas incidentit apo jo?

Bekim Luli: Jo.

Ferdinando Buatier: A mund të na përshkruani personin që e quajti veten Gjelosh? Çfarë ju kujtohet për të? Fizikisht?

Bekim Luli: Kanë kaluar 10 vite. Ishte pak i shkurtër dhe pak i shëndoshë. Kanë kaluar 10 vite.

Ferdinando Buatier: Personi që e quajti veten Gjelosh në mars 1999, a ishte drejtuesi i grupit prej ushtarëve?

Bekim Luli: Nuk e di. E dëgjova vetëm atë duke folur.

Ferdinando Buatier: A ka folur ky?

Bekim Luli: Vetëm ky, sa isha unë aty.

Ferdinando Buatier: A ju kujtohet a u ka thënë ushtarëve të tjerë se çfarë duhet bërë?

Bekim Luli: Nuk më kujtohet.

Kryetari i Trupit Gjykses: Një qartësim. Kur grupi me uniformë mori Pashkë Lulin, a tha diçka personi që e quajti veten Gjelosh?

Bekim Luli: Ai vetëm tha "do ta marr në fshat dhe do ta kthej". Por, unë nuk isha aty.

Kryetari i Trupit Gjykses: Vetëm të shkojë në fshat apo të shkojë në fshat për të bërë diçka?

Bekim Luli: Ai tha "do të shkojmë në fshat për të mbledhur ca armë".

1.3 Përmbledhje

Në deklaratën e tij për policine e UNMIK-ut më 16 mars të vitit 2008 i akuzuari i parë tha se një prej ushtarëve ishte Gjelosh Krasniqi nga fshati Nepole. Ai tha se nuk i njihte të tjerët. Eshte e qartë i akuzuari i parë e njihte Gjelosh Krasniqin, ose, me së pakti, e ka njohur Gjelosh Krasniqin.

Kur dëshmoi më 12 mars 2009 i akuzuari i parë mohoi se ai e njihte Gjelosh Krasniqin apo se e kishte identifikuar atë. Kjo ishte në kontradiktë të qartë me deklaratat e mëparshme të tij.

Kur eshte sfiduar lidhur me atë kontradikte, i akuzuari i pare pretendoi se një pjesë e deklaratës ishte "fabrikuar" - një trillim ky. Ai mohoi faktin se kishte identifikuar Gjelosh Krasniqi. Deklarata eshte shkruar në gjuhën shqipe dhe eshte firmosur nga i pandehuri i parë.

Gjykata konstaton se dëshmia e të akuzuarit e parë dhene para Gjykatës më 12 mars 2009 ishte e rreme në disa aspekte materiale të ndryshme. Dëshmia e tij I kundërshtoi deklaratat e mëparshme të tij. Në veçanti, i akuzuari I parë dëshmoi se më 24 mars 1999 ai nuk e njihte Gjelosh Krasniqin. Ai tha se një person thjesht u pezantua si Gjelosh Krasniqi. Kjo ishte një gënjeshtër. Është e qartë nga deklarata e tij e meparshme se ai e njihte Gjelosh Krasniqin dhe qe ai ishte nga fshati Nepole.

Gjykata konstaton se i akuzuari i parë dha një deklaratë të rreme, kur ai dëshmoi para gjykatës më 12 mars 2009 në rastin e Gjelosh Krasniqit.

2. I pandehuri I dyte

I padituri i dytë dëshmoi para Gjykatës së Qarkut në Pejë në rastin e Gjelosh Krasniqit me 17 mars 2009⁵.

Perpara dëshmisë së tij para se Gjykates, më 16 mars të vitit 2008 i akuzuari i dytë i dha një deklaratë policisë

⁵ Prova P3

së UNMIK-ut në lidhje me provat e çështjes në fjale.

Sipas pretendimeve të Aktakuzës së padituri i dytë dha një deklaratë të rreme, kur ai dëshmoi para gjykatës më 17 mars 2009, duke kryer vepër penale sipas nenit 307 (1) të LPK-së.

Sipas Prokurorisë dëshmia e të paditurit të dytë dhene para Gjykatës më 17 mars 2009 ishte, në disa aspekte materiale të rëndësishme, e rreme dhe kundërshtoi deklaratat e tij dhena paraprakisht.

2.1 Deklarata e dhënë për Policinë e UNMIK-ut më 16 mars 2008

I pandehuri i dytë nuk mund as të lexojë e as të shkruajë. Deklarata është shkruar në gjuhën shqipe dhe e firmosur nga i pandehuri i dytë. I pandehuri ishte i pranishëm kur vëllai i tij ishte intervistuar. Të pandehurit të dytë ju lexua deklarata përpara se ai ta nënshkruante atë.

Në deklaratën e tij i padituri i dytë pohoi deklaratën e vëllait të tij Bekim Luli se më 24 mars 1999 Gjelosh Krasniqi nga fshati Nepole, së bashku me ushtarë të tjerë të UÇK-së, kishte marrë Pashk Lulin.

Për më tepër, ai deklaroi se, pas luftës, kur ai ishte duke punuar si roje sigurimi në pompen e benxines Alfa në fshatin Doblibare, Gjelosh Krasniqi ndaloi makinën që ai po e ngiste dhe e pyeti se ku ishte Lusi (pronari i pompës së benxines) Ai u përgjigj se Lusi nuk ishte atje e ku më pas Gjelosh Krasniqi ka deklaruar se në qoftë se do të dilte nga makina ai "do të shkatërronte këto pompa, Unë do të djeg ato".

2.2 Deklarata para Gjykatës më 17 mars 2009

I padituri i dytë kujtoi një deklaratë që kishte dhënë në polici dhe deklaroi se ai kishte rënë dakord me deklaratën e dhënë nga Bekim Luli.

Ai dëshmoi se më 24 mars 1999 ai ishte në shtëpinë e xhaxhait të tij Nikoll Luli, kur pesë ushtarë të UÇK-së në uniforma ushtarake hynë në oborr. Ai e përshkroi ushtarin i cili u paraqit si udhëheqesi të shkurtër dhe topolak. Ai e përshkroi Pashk Lulin duke u marrë nga ushtarët.

Ai mohoi të ketë njohur Gjelosh Krasniqin në natën në fjale dhe dëshmoi se një nga ushtarët thjesht e ka paraqitur veten si Gjelosh Krasniqi.

I padituri i dytë ishte marrë pyetje në lidhje me kontradiktat midis dëshmisë së tij para gjykatës dhe deklaratën e tij të 16 marsit 2008.

Prokurori Publik: Unë do të doja që ju të mendoni përsëri për marsin e kaluar në 16, a ju kujtohet te keni dhënë një deklaratë për oficerin e policisë së bashku me vëllain e Bekim tuaj?

Engjell Luli: Po dhame deklaratata.

Prokurori Publik: A ju kujtohet çfarë keni thënë në lidhje me deklaratën e vëllait tënd në polici? Mund të bej disa pyetje në lidhje me deklaratën, I nderuari gjykates? Kjo eshte se si do ballafaqoj me fjalet e tij .. Unë po i referohem deklaratës, e cila është e përfshirë në faqet 102-105 dhe është në dosjen e gjykatës. A ju kujtohet duke thënë në polici se jeni dakord plotësisht me deklaratën e dhënë nga vëllai juaj Bekim?

Engjell Luli: Une mund te pergjigjem per deklaraten time por nuk mund te pergjigjem per deklaraten e vëllait tim.

Prokurori Publik: A ju kujtohet te keni thënë si më poshte për oficerin e policisë: "Unë pajtohem plotësisht me deklaratën e Bekimit, vëllait tim i cili dha deklaratë për zhdukjen e xhaxhait tone Luli tonë Pashk te cilin e moren Gjelosh Krasniqi së bashku me ushtarë të tjerë të UÇK-së"?

Engjell Luli: Une nuk isha me Bekimin, isha vetem. Mund te betohem per kete.

Prokurori Publik: A ju kujtohet qe t'ja keni thene kete policit?

Engjell Luli: Deklaraten time, po.

Prokurori Publik: A ju kujtohet kjo qe sapo citova nga deklarata juaj?

Kryetari i Trupit Gjykses; A e kuptoni pyetjen? A ju kujtohen keto fjale qe keni thene; se ju I qendronit deklarates se vellait tuaj Bekim? A keni kuptuar pyetjen e prokurorit publik?

Engjell Luli: Po. Sic ju thashe ne ishim 4 vellezer, dhe kur ata pyeten per xhaxhain tim Pashk Luli, xhaxhai im u ngrit ne kembe..

Kryetari i Trupit Gjykses; Me duhet t'ju nderpres ketu. Nuk eshte kjo pyetja. Prokurori Publik ju ballafaqoi me deklaratën tuaj të mëparshme në të cilën ju tha, dhe ai citon fjalët tuaja: "Unë pajtohem plotësisht me deklaratën e vellait tim, Bekimit i cili i dha deklaratë për zhdukjen e xhaxhait tone Pashk Luli i cili u mor nga Gjelosh Krasniqi së bashku me ushtarë të tjerë të UÇK-së. "Kjo është ajo që ju thate më 16 mars 2008.

Engjell Luli: Po kjo eshte cfare kam thene.

Prokurori Publik: Ju e dini atehere per deklaratën e vellait tuaj dhene në polici, sepse ju keni thënë ne polici se keni rënë dakord me atë që Bekimi tha.

Engjell Luli: Po ne ishim së bashku.

Kryetari i Trupit Gjykses; Ju ishit bashke kur jeni marre ne interviste nga policia?

Engjell Luli: Se pari vellai im e pastaj une.

Kryetari i Trupit Gjykses; Së pari, vellai juaj është intervistuar dhe pastaj jeni intervistuar ju, por të gjithë kohën të dy ju ishit të pranishëm?

Engjell Luli: Jo.

Ferdinando Buatier: Ndersa intervistohej Bekimi, a ishit ju ne dhome?

Kryetari i Trupit Gjykses informon Gjergj Lulin, I cili nuk duket mire, qe ai mund te largohet nga salla kur te deshiroje.

Engjell Luli: Jo. Une e kuptova te gjithë kete. Se

pari ishte Bekimi qe eshte intervistuar.

Kryetari i Trupit Gjykses; Nga e dinit ju permbajtjen e deklarates se tij?

Haxhi Millaku: Në përgjigje të pyetjes së parë të prokurorit publik e cila ka është shenuar në procesverbal, ky dëshmitar ka thënë: "Unë jam intervistuar në fshatin Doblibare." Ne nuk mund t'i referohemi zyrës.

Kryetari i Trupit Gjykses; E kisha fjalen per dhome/salle-dhe perkthyesi perdori fjalen "zyre". Megjese jut hate ne 16 qe ju I qendruat deklarates se vellait tuaj Bekim, nga e dinit kete deklarate? A degjuat se cfare tha ai ne polici, apo u a kane lexuar deklaraten e vellait? Nga e dinit per kete deklarate?

Engjell Luli: Une nuk di te lexoj.

Prokurori Publik: A ja u kane lexuar?

Engjell Luli: Ai qe ishte atje ma lexoi.

Kryetari i Trupit Gjykses; A ishte ai zyrtar policor?

Engjell Luli: Nuk kishte veshur uniforme.

Kryetari i Trupit Gjykses; A ishte Shqiptar apo Amerikan?

Engjell Luli: There was one of each.

Kryetari i Trupit Gjykses; Ai qe lexonte ishte Shqiptar?

Engjell Luli: Po.⁶

Prokurori Publik: Une do te perseris deklaraten e meposhteme nga deklarata e vellait tuaj. Kjo ju eshte lexuar juve: "Ne oborrin e shtepise se xhaxhait tim Nikoll ishin ushtare te UCK-se. Ndermjet ketyre ishte

⁶ Pjese nga procesverbali I gjykimit kryesor 17.03.2009, faqet 5 – 7.

Gjelosh Krasniqi nga fshati Nepole, komuna e Pejes ndersa ushtaret e tjere nuk I njoha." A keni rene dakord me deklaraten ne mars 2008. A jeni dakord me ate deklarate tani?

Engjell Luli: Po une nuk kam thene ne asnje moment Gjelosh Krasniqi. Mendoj se ai u prezantua si Gjelosh Krasniqi. Tani nuk e njoh dhe asnjehere nuk e kam njohur.

Prokurori Publik: Vëllai juaj tha se ai e ka njohur atë dhe ju keni rënë dakord me vëllain tuaj.

Engjell Luli: Kjo nuk është e vërtetë

Kryetari i Trupit Gjykes: Ju nuk mund të thoni keshtu për shkak se ju nënshkruat deklaraten. Ju mund të thoni keshtu, pasi tani kujtesa juaj është e ndryshme. Cila është kujtesa juaj tani?

Engjell Luli: Unë nuk e di çfarë të them. Cila është kujtesa ime tani? Kanë kaluar dhjetë vjet.

Kryetari i Trupit Gjykes: Ju jeni këtu për të na shpjeguar se çfarë mbani mend. Në 16 mars, ju I qendruat deklaratës se vëllait tuaj i cili tha se ai e ka njohur Gjelosh Krasniqin gjithashtu duke shtuar se ai ishte nga fshati Nepole. Vëllai juaj nuk tha thjesht: "Unë pashë dike" ai tha: "Unë pashë Gjelosh Krasniqin", i cili është pikerisht nga ky fshat. Konkluzioni logjik është se ai e ka njohur Gjelosh Krasniqin dhe po në të njëjtën ditë, ju thatë se keni rënë dakord plotësisht me këtë deklaratë, që do të thotë se atë natë ju gjithashtu e pate Gjelosh Krasniqin dhe ju gjithashtu kuptuat që ai vinte nga fshati Nepole. Kjo është çfarë ju thatë më 16 mars. Ju nuk mund ta mohoni këtë për shkak se keni nënshkruar deklaraten. Kjo është në dosjen e gjykatës dhe është histori dhe do të vlerësohet nga gjykata. Ju jeni këtu për të na shpjeguar se çfarë mbani mend aktualisht. Ne e dimë se çfarë ju kujtohej në datën 16 mars. nuk mund ta mohoni sepse ju nënshkruat. Ju jeni këtu në këtë moment të na informoni në lidhje me memorjen tuaj momentalisht për faktet lidhur me vitin 1999. Çfarë ju kujtohet tani?

Engjell Luli: Ai u prezantua vete. Unë nuk e njoha atë. Po të kisha njohur atë, unë do të thoja që une e njoh atë. Unë nuk jam duke mohuar deklaratat që dhashë. Përveç kësaj, unë kam humbur dy ditë pune. Ai mendoi se une kisha ikur apo larguar. Policia erdhi në shtëpinë time dhe ...

Kryetari i Trupit Gjykses: Ju mund ta ngrini këtë çështje kur dëshmia juaj të perfundojë e jo tani. Që kjo është kujtesën tuaj tani që ju nuk e njihni Gjeshosh Krasniqin, pse keni thënë në 16 që Gjeshosh Krasniqi ishte nga fshati Nepole? Kjo është njëjtë sikur...

Haxhi Millaku ndwrhyn: Kryetari i Trupit Gjykses ka vendosur tashmë mbi kundërshtimin e tij dhe kjo është në procesverbal.

Kryetari i Trupit Gjykses: Si është e mundur që është kjo kontradiktë?

Engjell Luli: Ju e keni para jush çfarë kam thënë atë ditë. Unë nuk e di se çfarë kam thënë 10 vjet më parë.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ju e keni thene këtë nje vit më parë dhe jo 10.

Engjell Luli: Po, 2008.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pse thoni diçka tjeter nje vit më parë?

Engjell Luli: Unë nuk e njoha ate, por I kam dhene këto deklarata.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ne baze te kujteses tuaj tani ju nuk e njihni atë, por ne të gjithë duam të dimë se pse është ky dallim në mes të dy deklaratave. Prokurori Publik, Avokati Mbrojtjes, dhe kolegji duan të dinë. Ka një ndryshim thelbësor në mes të dy deklaratave.

Engjell Luli: Nuk ka asnjë ndryshim. Unë nuk e di se çfarë tha ai apo se si e tha.

Kryetari i Trupit Gjykses: Kush "Ai"?

Engjell Luli: Ju jeni duke thënë se unë kam ndryshuar mendjen.

Kryetari i Trupit Gjykses: Nuk është që ju keni ndryshuar mendjen, por ka mospërputhje në mes të dy deklaratave dhe unë dua të di pse?

Engjell Luli: Çfarë deklaratash?

Ferdinando Buatier: Në vitin 2008, ju thatw, duke kujtuar deklaratën e vëllait tuaj Bekim, që ju e njihni GjeloSh Krasniqin dhe se ishte nga fshati Nepole. Sot, ju thate se ju nuk e njihnit GjeloSh Krasniqin dhe se ky person që ju nuk e njihnit është paraqitur si GjeloSh Krasniqi. Pse thoni dy gjëra të ndryshme?

Engjell Luli: Ai e paraqiti veten si GjeloSh Krasniqi, por unë nuk e njoha atë.

Ferdinando Buatier: A e kuptoni se ka një dallim mes asaj që ju jeni duke thënë sot dhe çfarë ju thate një vit më parë. Keto janë dy gjëra të ndryshme.

Engjell Luli: Më vjen keq, por unë nuk e kuptoj.

Ferdinando Buatier: Sot ju thate se ju nuk e njihnit GjeloSh Krasniqin, por një vit më parë, ju thatë se e keni njohur.

Engjell Luli: Unë nuk e kam thene kete.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ju nuk mund të mohoni që e keni thene një gjë te tillë. Ju mund të thoni se ju kujtohet ndryshe. Sic edhe keni thwnw, sepse ju thate që ju kujtohet në një mënyrë të ndryshme dhe ne jemi këtu për t'ju pyetur perse. Nëse ju mund të na tregoni pse, ne do të marrim përgjigjen në konsideratë. A mund të na shpjegoni pse ekziston ky ndryshim? Nëse ju nuk mund ta shpjegoni, kjo është në rregull. Cila është përgjigjja juaj?

Engjell Luli: Nuk e di.

Prokurori Publik: Unë do t'ju lexoj një pjesë tjetër të deklaratës me të cilën keni rënë dakord, dhe kjo është deklarata që Bekimi, vëllai yt dha në polici më

16 mars 2008 dhe e cila është lexuar për ju dhe ju keni rënë dakord me të: "Së pari, Gjeloš Krasniqi pyeti për xhaxhin tim Pashke për t'i dhënë atij armët ...

Kryetari i Trupit Gjykoës: Ai nuk e mohoi se xhaxhai e tij dorëzoi disa armë. Është më mirë të pyesni atë nëse xhaxhai i tij i ka dorëzuar armët apo jo dhe nëse ka ndonjë mospërputhje atëherë ju mund ta ballafaqoni me atë.

Prokurori Publik: A i është kërkuar xhaxhait tuaj ti kthente armët Gjeloš Krasniqit dhe ushtarëve të tjerë?

Engjell Luli: Po, xhaxhai im u dha armët atyre.

Prokurori Publik: A ishte kjo sipas urdhurit të Gjeloš Krasniqit?

Engjell Luli: Po.⁷

Prokurori Publik: Dëshiroj t'ju kujtoj periudhën pas mbarimit të luftës dhe e kujtoj që keni qenë duke punuar në pompën e benzines Alfa dhe se kjo gjendet në fshatin tuaj Doblibare.

Engjell Luli: Po.

Prokurori Publik: A ju kujtohet që në një moment Gjeloš Krasniqi të ketë ardhur te pompa e benzines?

Engjell Luli: Ai kaloi në rrugën aty.

Prokurori Publik: A keni biseduar me të?

Engjell Luli: Nga një distancë prej 5 metrash

Prokurori Publik: Sa kohë pasi kishte përfunduar lufta?

Engjell Luli: Ishte erresirë, ishte natë.

⁷ Pjesë nga proceverbali i gjykimit kryesor të datës 17.03.2009, faqet 8 – 10.

Prokurori Publik: Sa jave pas luftes?

Engjell Luli: Nuk mund t'ju genjej por ka gene menjwhere pas lufte. Menjehere pas lufte.

Prokurori Publik: Na tregoni per takimin tuaj me Gjelosh Krasniqin te pompa e benxines aty afer ose menjwhere pas luftes.

Engjell Luli: Une nuk e kam takuar ate.

Prokurori Publik: Ndonje bisede apo fjale e shkembyer?

Engjell Luli: Ai me ka folur nga rruga.

Prokurori Publik: Cfare I thate ju?

Engjell Luli: Ai me tha: "Nese do vi afer teje, Une do ta hedh ne ere pompen tende te benxines" Pwrgjigjia ime ishte "I forti mund te beje gjithcka."

Kryetari i Trupit Gjykues: Kush I tha keto fjale, ju apo Gjelosh Krasniqi?

Engjell Luli: Une I thashe.

Prokurori Publik: A e keni pare Gjelosh Krasniqin qe nga ajo kohe te pompa e benxines?

Engjell Luli: Jo.

Prokurori Publik: A e shihni Gjelosh Krasniqin ketu ne kete salle? Kthehu dhe shikoji te gjithë.

Deshmitari kthehet per te pare ne sallën e gjykimit

Engjell Luli: Nuk me kujtohet. Ai ishte shume me I shkurter dhe me I shendoshe.

Prokurori Publik: Cili, Gjelosh Krasniqi? Ai qe mori xhaxhain tuaj apo ai te pompa e benxines?

Engjell Luli: Ai ishte ne makine dhe nuk doli jashte. Une nuk munda ta shihja ate.

Prokurori Publik: Gjeloš Krasniqi qe mori xhaxhain tuaj dhe ai te pompa e benxines eshte I njejti person apo jo?

Engjell Luli: Ishte erresire dhe nje disatnce prej 5 metrash.

Kryetari i Trupit Gjykues: Te oborri I xhaxhait tend apo te pompa e benxines?

Engjell Luli: Pasi ata moren xhaxhain tim.

Kryetari i Trupit Gjykues: A ishte erresire ne oborrin e xhaxhait tend?

Engjell Luli: Ishte erresire.

Kryetari i Trupit Gjykues: A ishte takimi te pompa e benxines gjate dites apo naten?

Engjell Luli: Ishte naten. Une punoja si roje.

Kryetari i Trupit Gjykues: A ishte nate apo jo? Zakonisht pompat e benxines jane te ndricuara mire.

Engjell Luli: Ishte erresire.

Kryetari i Trupit Gjykues: Po edhe te pompa e benxines?

Engjell Luli: Po.

Kryetari i Trupit Gjykues: Gjeloš Krasniqi personi qe mori xhaxhain tuaj dhe personi qe keni takuar te pompa e benxines, a jane I njejti person apo jo?

Engjell Luli: Ju po me konfuzoni.

Kryetari i Trupit Gjykues: Nuk po te konfuzoj. Personi qe u prezantua si Gjeloš Krasniqi mori xhaxhain tuaj- ju e thate kete gjate seances. Sa I perket pyetjes se prokurorit publik, ju thate se, pas luftes, ju e keni pare Gjeloš Krasniqin te pompa e benxines. Po ju pyes nese Gjeloš Krasniqi qe ju pate te marre xhaxhain tuaj dhe Gjeloš Krasniqi qe ju pate te pompa e benxines jane I njejti person apo jo? Eshte pyetje shume e thjeshte.

Engjell Luli: Une nuk pata bisedw tw gjatw me tw...

Kryetari i Trupit Gjykues: A janw ata I njwjti person apo jo?

Engjell Luli: Jo ata jane te ndryshem.

Kryetari i Trupit Gjykues: atehere, kjo eshte pergjigjia juaj. Megenwse jane dy persona te ndryshem, perse nuk e keni deshmuar kete ne deklaraten tuaj te dhene nje vit me pare. Se pari ju thate, qe bini dakord plotesisht me deklaraten e vellait tuaj. Ne deklarate behet fjale per rrembimin e xhaxhait tuaj nga nje grup njerezish ndermjet te cileve ishte dhe Gjelosh Krasniqi dhe me pas ne deklaraten tuaj dhene me vone ne 16 mars, ju thoni qe e keni pare Gjelosh Krasniqin pas luftes. Perfundimi llogjik qe del nga kjo deklarate dshtd qe dy Gjelosh Krasniqet, ai qe ka rrembyer xhaxhain tuaj dhe ai I pompes se benxines jane I njejtj person. Tani ju po thoni qe ata jane dy persona te ndryshem. Perse nuk e keni thene kete ne 16 mars? Edhe pse ju jeni person I pashkolluar, ju e kuptoni qe kjo eshte e rendesishme.

Engjell Luli: Ishte perkthyesi qe ka bere perkthimin. Ju mund ti thoni Gjyktesit cfare te deshironi, dhe mund te ndodhe qd ju te perdorni nje sharje dhe une nuk do ta kuptoja.

Kryetari i Trupit Gjykues: Kjo deklarate eshte ne Shqip. Nuk ka asgje te beje me perkthimin.

Engjell Luli: Une ju kam thene tashme dhe e kam vene veten ne dispozicionin tuaj. Nuk mund te them asgje per kete ose lidhur me deklaraten time.

Kryetari i Trupit Gjykues: Dua te di se perse nuk keni treguar qe keta dy persona me emrin Gjelosh Krasniqi kane qene dy persona te ndryshem.

Engjell Luli: Ndoshta dike e kane ngaterruar per nje person tjeter dhe mund te demtoj dike tjeter.

Kryetari i Trupit Gjykues: Perse nuk e permende kete ndryshim?

Engjell Luli: Nuk di se si ta shpjegoj kete. Ju po me shkaterroni.

Kryetari i Trupit Gjykues: Cfare doni te thoni me kte. A jeni I frikesuar nga ndonjw gje?

Engjell Luli: Jo.

Kryetari i Trupit Gjykues: Perse

Engjell Luli: Une nuk dua te shkaterroj besimin e dikujt tjeter.

Kryetari i Trupit Gjykues: A jeni kercenuar lidhur me deklaraten tuaj ne gjykate?

Engjell Luli: Jo asnjehere.⁸

Kryetari i Trupit Gjykues: Me duhet te kerkoj per dy qartesime nga ju. Keta ushtaret ishin te veshur me uniforma. A I njohet ju keto uniforma? Ose, a mos vute re qe te ishte ushtria?

Engjell Luli: Uniformat ishin tw njwjta - si te cdo ushtriye.

Kryetari i Trupit Gjykues: meqense ne deklaraten tuaj te 16 marsit 2008 ju thate qe "xhaxhai im Pashk Luli eshte marre nga Gjelosh Krasniqi e ushtare te tjere te UCK-se." Ju e thate kete ne 16 mars 2008. Cila eshte memorja juaj tani?

Engjell Luli: Ai tha qe ishte Gjeloshi. Ai kishte veshur uniforme.

Kryetari i Trupit Gjykues: Atehere personi qe u prezantua si Gjelosh Krasniqi ishte me uniforme?

Engjell Luli: Po.

Kryetari i Trupit Gjykues: Gjithashtu edhe te tjeret?

⁸ Pjese nga seanca kryesore e mbajtur me 17.03.2009, faqet 12 – 14.

Engjell Luli: Po.

Kryetari i Trupit Gjykues: A mund te dallonit nje uniforme te UCK-sw, meqenese sic thate ishte erresire?

Engjell Luli: Ishte erresire.

Kryetari i Trupit Gjykues: Meqenese ishte erresire, per kete arsye ju nuk mund ta dallonit dot fytyren e personit te prezantuar si Gjelosh Krasniqi, si mundet ti dallonit uniformat?

Engjell Luli: Kete e kuptuam me vone.

Kryetari i Trupit Gjykues: Si e kuptuat kete me vone?

Engjell Luli: Kuptuam qe ishte ushtria jone. Ajo shqiptare.

Ferdinando Buatier: A ju tha dikush?

Engjell Luli: Askush nuk mw tregoi. Pasi kjo ishte kur filloi lufta. Ne e dinim se cilat pale ishin te perfshira.

Kryetari i Trupit Gjykues: Ju thoni qe ishte perfundimi i juaq qe ata ishin UCK, dhe jo se pate dicka drejtperdrejte?

Engjell Luli: Po.

Kryetari i Trupit Gjykues: Kjo pergjigje nuk eshte e qendrueshme me cfare na thate pak me pare.

Engjell Luli: Ishte errwsirw, ai kishte veshur uniforme.

Kryetari i Trupit Gjykues: Ju nuk dalluat ndonje shenje apo embleme ne uniforme?

Engjell Luli: Nuk e di. Une doja te kthehesha te familja ime.⁹

⁹ Pjese nga seanca e gjykimit kryesor te dates 17.03.2009, faqet 21 – 22.

2.3 Përmbledhje

Në deklaratën e tij të 16 mars 2008 i padituri i dytë pranoi deklaratën e vëllait të tij Bekim Luli.

Për më tepër, ai deklaroi se, pas luftës, kur ai ishte duke punuar si roje e sigurimit në pompen e benzines Alfa Petrol në fshatin Doblibare, Gjelosh Krasniqi ndaloi makinën që ai po e ngiste dhe e pyeti atë se ku ishte pronari i stacionit të benzines. Ai u përgjigj pronari nuk ishte aty, ku më pas Gjelosh Krasniqi tha se në qoftë se do të dilte nga makina ai "do të shkatërronte këto pompa, Unë do të djeg ato".

Megjithatë, kur ai dëshmoi më 17 mars 2009 i padituri i dytë mohoi të ketë njohur Gjelosh Krasniqin më 24 mars 1999. Ai tha se njëri nga ushtarët thjesht u identifikua si Gjelosh Krasniqi. Ai e përshkroi ushtarin i cili doli të jetë udheheqesi me trup të shkurtër dhe topolak.

Është e qartë nga deklarata e tij e mëparshme se ai e njohte Gjelosh Krasniqin nga fshati Nepole.

Për më tepër, edhe pse incidenti në pompën e benzines ka ndodhur pas luftës është e qartë nga deklarata e dytë e të pandehurit se ai është duke iu referuar të njëjtit person që ai thotë se ishte i pranishëm më 24 mars 1999 dhe të cilin ai e identifikoi si Gjelosh Krasniqi.

Gjykata konstaton se dëshmia e të pandehurit të dytë para Gjykatës më 17 mars 2009 ishte e rreme në aspektet e ndryshme materiale. Dëshmia e tij kundërshtoi deklaratën e tij të mëparshme. Në veçanti, i pandehuri i dytë dëshmoi se më 24 mars 1999 ai nuk e njohte Gjelosh Krasniqin. Ai tha një person thjesht u prezantua si Gjelosh Krasniqi. Kjo ishte një gënjeshtëri. Ai e njohte Gjelosh Krasniqin nga fshati Nepole. Ai ishte i njëjti person me të cilin ai kishte folur te pompa e benzines pas luftës.

3. I pandehuri i tretë

I pandehuri i tretë dëshmoi para Gjykatës së Qarkut të

Pejës në rastin e Gjeloš Krasniqi me 17 mars 2009¹⁰.

Para se të jepte dëshminë së tij para Gjykates, më 16 janar 2008 pandehuri i tretë i dha një deklaratë policisë së UNMIK-ut në lidhje me faktet në çështjen ne fjale.

Sipas Aktakuzes I pandehuri i tretë dha një deklaratë të rreme, kur ai dëshmoi para gjykatës më 17 mars 2009, duke kryer vepër penale sipas nenit 307 (1) të LPK-së.

Argumenti i Prokurorise eshte se dëshmitë e të akuzuarit te tretë dhene para Gjykatës më 17 mars 2009 jane, në disa aspekte materiale të rëndësishme, të rreme dhe kundërshtojne deklaratat e tij te meparshme.

3.1 Deklarata e dhënë për Policinë e UNMIK-ut më 16 janar 2008

I pandehuri i tretë ka deklaruar se gruaja e Pashk Lulit, Zoja, më 24 mars 1999 rreth 20:00 së bashku me gruan e Gjergj Lulit, Terezen, erdhen në shtëpinë e tij për tu strehuar nga bombardimet.

I pandehuri i tretë, së bashku me babain e tij, shkuan në shtëpinë e Nikollë Lulit.

Rreth 08:30 djali I Nikollës, Prenku, njoftoi ata se Pashk Lulin e kishin marrë. Ai përshkroi te kishte parë një ushtar me uniformë të UÇK-së me simbolin e UÇK-së. Ai tha se nuk e njeh atë ushtar.

Ai deklaroi se rreth 11:30 ai kishte dëgjuar një anëtar te familjes te thote se "xhaxhai jone u kthye". Ai shkoi jashtë dhe pa Gjeloš Krasniqin së bashku me tre ushtarë të tjerë në oborr. Ai kujton, qe Gjeloš Krasniqi I thote Pashk Lulit "Çohu dhe eja me ne".

Deklarata eshte shkruar në gjuhën shqipe dhe eshte e nënshkruar nga i pandehuri i tretë.

3.2 Dëshmia para Gjykatës më 17 mars 2009

¹⁰ Prova P

I pandehuri i tretë dëshmoi se më 24 mars 1999, ai ishte në shtëpi duke parë televizor me babain e tij Mark Lulin dhe të afërm të tjerë, kur disa fëmijë që ishin jashtë erdhen dhe thane se Pashk Lulin e kishin marre.

Ai tregoj qw shkoi në oborrin e shtëpisë ku ai u takua kushërinjtë e tij që i thanw atij se Pashk Lulin e kishin marrw. Ai tha se nuk e pa nga kush. Ai tha qe u kthye perseri në shtëpi për të parë TV.

Ca kohë më vonë Pashk Luli u kthye i shoqëruar nga tre ose katër ushtarë të UÇK-së. Ai tha se nuk njohu asnjë prej ushtarëve.

I pandehuri i tretë eshte marre në pyetje në lidhje me kontradiktat midis dëshmisë së tij para gjykatës dhe deklaratës se tij të datës 16 janar 2008.

Prokurori Publik: Dua t'ju pyes nese ju kujtohet te keni dhene deklarate ne 16 Janar 2008? A ju kujtohet te keni dhene deklarte ate mbremje?

Prenk Luli: Po.

Prokurori Publik: Po ajo deklarate eshte dhene ne polici apo jo?

Prenk Luli: Po.

Prokurori Publik: A ju kujtohet te keni dhene kete pjese te deklarates?

Prenk Luli: Nuk kam thene asgje. As qe kam pare.

Prokurori Publik: Cfare te shihnit?

Prenk Luli: Asnje te armatosur.

Prokurori Publik: degjoji pyetjet e mija. A ju kujtohet te keni thene ne deklaraten tuaj ne polici ne 16 janar 2008, se pasi degjuat nga femijet qe xhaxhain tuaj e kishin marre, ju u shprehet si ne vijim: "Ne te njejtën kohe, une shkova ne oborrin e Nikoles dhe pashe nje person te armatosur qe kishte veshur uniforme te UCK-se. Ai kishte embleme te UCK-sw, por nuk e dallova kush ishte." A ju kujtohet ta keni thwnw

kwtw?

Prenk Luli: Nuk e kam thene dhe nuk me kujtohet ta kem thene pasi nuk pashe askend ne oborr.

Prokurori Publik: Ju po e mohoni qe e keni thene?

Prenk Luli: Nuk e thashe kete.

Prokurori Publik: Me tej ne deklaraten tuaj: "Une e pyeta ate: 'Kush jeni ju' dhe ai mw tha: 'Une jam nga Kosova, dhe nuk eshte e rendesishme per ju ta dini se kush jam une" dhe me pas ju thate: "Pas bisedes qe une pata me personin me uniforme, une hyra ne shtepi, ndersa ai vazhdoi te qendronte jashte ne oborr si roje." A mund te na shpjegoni se si ky informacion hyri ne deklaraten tuaj qe ju keni nenshkruar?

Prenk Luli: Une nuk e di se kush e ka shkruar ate. Une pashe qe atje ishin tre nga kater persona kur e kthyen xhaxhain tim, por ishte erresire dhe nuk munda te shoh asgje tjeter.

Prokurori Publik: Ju nuk mund te shpjegoni se si ka hyre kjo ne deklaraten tuaj.

Prenk Luli: Nuk e di.

Prokurori Publik: Edhe pse ju e keni nenshkruar kete?

Prenk Luli: Une e kam nenshkruar por nuk e dija se cfare ishte shkruar. Si mund ta dija?

Prokurori Publik: Ky ishte nje hetim I rendesishem, a nuk patet parasysh se cfare po nenshkruanit?

Prenk Luli: Babai im ishte shume I semure. Une u morra me te tjera gjera. Nuk vura re se cfare shkruajti ai njeri. Pata per te cuar babain ne spital dhe nuk e di se cfare eshte shkruar.

Prokurori Publik: Ishte ne Shqip. Ju e keni nenshkruar.

Prenk Luli: Po, e kam nwnshkruar.¹¹

¹¹ Pjese nga procesverbali I gjykimit kryesor 17.03.2009, faqe 48 -- 49.

Prokurori Publik: Me lejoni t'ju pyes rreth deklaratës se meposhteme dhene ne Janar 2008, Citoj: "Rreth ores 23.00 Gjeloš Krasniqi, sebashku me tre partneret e tij, erdhi ne oborr. Degjova nga njeri prej anwtareve te familjes qe xhaxhai jone ishte kthyer. Per kete dola perseri jashte." A ju kujtohet ta keni thene kete ne janar 2008?

Prenk Luli: Po.

Prokurori Publik: A mund te degjoje se cfare fjalesh thuheshin?

Prenk Luli: Jo.

Prokurori Publik: Mw pas ne deklartate ju keni thene: "Nuk mund te degjoja cdo gje por degjova shume mire fjalet e Gjeloš Krasniqit qe thoshte: 'cohu dhe hajde me ne'".

Haxhi Millaku: Versioni shqip, ben fjalw pwr tw kundwrtwn. Nd atd version thuhet: " Une nuk degjova mire."

Prokurori Publik: "Nuk mund te degjoja cdo gje shume mire, se cfare thoshte Gjeloš Krasniqi."

Haxhi Millaku: "Nuk mund te degjoja mire" vesioni ne shqip. Fjalet " cohu dhe hajde me ne qe Gjeloš Krasniqi tha- I degjova shume mirw."

Kryetari i Trupit Gjykues: Eshte e njejta gje. Ju mund te pergjigjeni tani.

Prokurori Publik: Ju e degjuat deklaraten; a bini dakord qe e keni dhene deklaraten?

Prenk Luli: Bie dakord, por jo me menyren se si eshte thene. Ai u prezantua si Gjeloš Krasniqi por une ate nuk e njoh dhe se kam pare asnjehere. Nuk eshte e vertete qe kam thene qe e njoh ate njeri.

Kryetari i Trupit Gjykues: Prokurori Publik nuk e tha kete. Per te gene te qarte, si ndodhi kjo? Cfare tha

pwrpara se te thoshte fjalet qe ai tha? Ku e prezantoi veten ai, meqenese ai u prezantua si Gjelosh Krasniqi?

Prenk Luli: Pasi ata e kthyen perseri.

Kryetari i Trupit Gjykues: Cfare tha?

Prenk Luli: Ai vetem tha: "Hajde me ne" dhe kjo eshte e gjitha.

Kryetari i Trupit Gjykues: Nga e dini qe ai u prezantua si Gjelosh Krasniqi?

Prenk Luli: Si e di une nese ishte ai apo jo?

Kryetari i Trupit Gjykues: Si ndodhi? Ne cfare momenti ate nate e prezantoi veten si Gjelosh Krasniqi?

Prenk Luli: Ai nuk tha se ai ishte Gjelosh Krasniqi. Une nuk e degjova ate te thoshte keshtu dhe ai nuk e tha kete.

Kryetari i Trupit Gjykues: Nga e dinit qe ai ishte Gjelosh Krasniqi meqe ne deklarate ju thate se Gjelosh Krasniqi se bashku me tre partneret e tij erdhi ne oborr?

Prenk Luli: Une degjova keto fjale: "Gjelosh Krasniqi e mori ate." Ne ate moment une nuk degjova ate te kete thene kete apo te jete prezantuar.

Kryetari i Trupit Gjykues: Dikush tjeter i tha keto fjale; "Gjelosh Krasniqi e mori ate." A ju kujtohet kush I tha keto fjale?

Prenk Luli: Jo.

Kryetari i Trupit Gjykues: A e degjuat dike ti thoshte keto fjale, apo pate dike qe ti thoshte keto fjale?

Prenk Luli: Dikush tha keshtu por une nuk pashe se kush.

Kryetari i Trupit Gjykues: Atehere ju vetem degjuat.

Prenk Luli: Vetem kam dwgjuar.¹²

...

Prokurori publik: Ju thatë se dikush i ka thënë fjalët: "Gjelosh Krasniqi", a është e saktë kjo?

Prenk Luli: Po.

Prokurori publik: Kush i ka thënë këto fjalë?

Prenk Luli: Nuk e di.

Prokurori publik: Në të njëjtën kohë, ju keni thënë se keni dëgjuar shumë mirë se Gjeloshi ka thënë: "Ngrihu dhe eja me ne. "Si e shpjegoni këtë? Si e njihni zërin e Gjeloshit aq mirë dhe jo zërin e dikujt tjetër?

Prenk Luli: Nuk e njoh zërin e Gjeloshit.

Prokurori publik: Kjo është e kundërt me atë që keni thënë në deklaratë.

Prenk Luli: Po ju tregoj tani se çfarë kam thënë dhe nuk mund të di se çfarë është shkruar në deklaratë.

Prokurori publik: Po përpigëni që t'i shmangeni deklaratës suaj, apo jo?

Prenk Luli: E di çfarë kam thënë.

...

Haxhi Millaku: A mund të kërkojë nga dëshmitari të kthehet me fytyrë nga i pandehur dhe të na thotë nëse e ka parë atë ndonjëherë me parë.

Kryetari i trupit gjykues: Po.

Dëshmitari kthehet me fytyrë nga i pandehuri.

Haxhi Millaku: A e keni parën ndonjëherë me parë këtë njeri?

¹² Pjese nga procesverbalet e Gjykimit kryesor 17.03.2009, faqet 49 – 51.

Prenk Luli: Nuk e kam parë.

Haxhi Millaku: Faleminderit.

3.3 Përmbledhje

I pandehuri i tretë dëshmoi se kur ushtarët e parë mbërriten ai nuk njohu ndonjë prej tyre. Kjo është në përputhje me deklaratën që ai dha për policinë e UNMIK-ut më 16 janar 2008. Megjithatë, ai më tej dëshmoi se kur ushtarët u kthyen më vonë me Pashk Lulin ai përsëri nuk njohu asnjë prej ushtarëve. Që kundërshton deklaratën e tij të parë.

Në deklaratën që ai dha të policia e UNMIK-ut më 16 janar të vitit 2008 ai tha se rreth 11:30 ai doli jashtë dhe pa Gjelosh Krasniqin së bashku me tre ushtarë të tjerë në oborr. Ai kujton që Gjelosh Krasniqi I tha Pashk Lulit "Çohu dhe eja me ne".

Deklarata e të pandehurit tretë ishte në gjuhën shqipe dhe ai e kishte nënshkruar atë.

Kur u konfrontua me kontradiktat midis deklaratave të tija dhe dëshmimeve të tija i akuzuari i tretë mohoi se ai kishte përmendur një person të armatosur të veshur me një uniformë të UÇK-së ose që ai kishte parë shenjën e UÇK-së. Në fakt, ai fillimisht e mohoi që kishte parë dikë në oborr.

I pandehuri i tretë mohoi që kishte identifikuar Gjelosh Krasniqin. Mohimi është i theksuar. Ai tha se një nga ushtarët thjesht "e kishte prezantuar veten si Gjelosh Krasniqi, por unë nuk e njoh atë dhe kurrë nuk e kam parë atë. Nuk është e vërtetë se kam thënë që unë e njoh atë njeri". Më vonë në dëshminë e tij i akuzuari i tretë e mohoi që ushtari e kishte prezantuar veten si Gjelosh Krasniqi dhe ia atribuoi këtë dikujt tjetër, të cilin ai nuk mund ta identifikojë, i cili kishte deklaruar se Pashk Lulin e kishte marrë Gjelosh Krasniqi.

Deklarata e të pandehurit të tretë ka kaq shumë mospërputhje të brendshme dhe kundërshton kështu deklaratën e tij të mëparshme që ishte thjesht e pajustificueshme.

Gjykata konstaton se dëshmia e pandehurit të tretë e dhënë para Gjykatës më 17 mars 2009 ishte e rreme në disa aspekte të ndryshme materiale. Dëshmia e tij kundërshtoi deklaratën

e tij të pare.

Duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e kësaj ceshtjeje Gjykata është e kënaqur që dënimet janë të arsyeshme dhe proporcionale.

Për arsyet e përmendura këtu unë parqes kete Aktgjykim.

Date 16 shtator 2010.

Gjykatesi Malcolm Simmons
Kryetari i Trupit Gjykues

Robina S. truthers
Procesmbajtese

KESHILLE LIGJORE: Në bazë të nenit 398 (1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, personat e autorizuar mund të paraqesin ankesë ndaj ketij gjykimi brenda (15) ditësh nga dita e kopjes së aktgjykimit.